



01 Nr. 1381
Rahovec, 23.04.2018

Në bazë të nenit 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës 03/L-040, nenit 4 pika 2 të Ligjit për Hoçën e Madhe, nenit 3 të Udhëzimit Administrativ nr. 11/2014 për themelimin, zgjedhjen, përgjegjësitë dhe funksionimin e Këshillit për fshatin Hoçë e Madhe dhe Vendimit 01 Nr.1031 për themelimin e Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, shpall këtë:

Ftesë Publike **Për themelimin e Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe**

Këshilli i fshatit Hoçë e Madhe përbëhet prej 5 anëtarëve, gjegjësisht 2 qytetarë të Komunës së Rahovecit - shqiptar; 2 banorë të fshatit Hoçë e Madhe dhe një nga Kisha Ortodokse Serbe, i cili duhet të jetë banor i fshatit Hoçë e Madhe.

Përgjegjësitë e Këshillit, ndër të tjera, kanë të bëjnë me mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë fetare dhe kulturore si dhe planifikimi hapësinor dhe rural të fshatit Hoçë e Madhe.

Ftohen të interesuarit që të konkurrojnë për anëtarë të Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe.

Preferohet që aplikantët të kenë përvojë në lëmitë vijuese:

- Ruajtjen, zhvillimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të fshatit Hoçë e Madhe, si dhe të komunës së Rahovecit në tërësi,
- Gjithashtu, preferohet që anëtarët e Këshillit të kenë kualifikime relevante-superiore siç janë: arkitektë, historianë, arkeologë, gjeografë ose pjesëtarë të OJQ-ve të ndryshme të cilat mirren me njohjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore.

Aplikacionet, që përbëhen nga kërkesa, CV-n dhe dëshmitë për përvojën tuaj në lëmit e theksuara më lartë, duhet t'i dorëzoni në Zyrën e pranimit të KK-së, duke cekur për Kryesuesin e Kuvendit të Komunës së Rahovecit.

Ftesa mbetet e hapur 15 ditë nga dita e publikimit të saj ne veb.faqen zyrtare te komunes si dhe në mjetet e informimit.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit, respektivisht pas datës 11 Maj 2018, nuk do të merren në shqyrtim.

